V E N D I M
Nr.85, datë 10.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Gjergj Sauli,	Anëtar i	“““
Zija Vuci,	Anëtar i	“““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	“““
Kujtim Puto,	Anëtar i	“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“““
Tefta Zaka,	Anëtare e	“““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	“““
Petrit Plloçi,	Anëtar i	“““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 10.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.86 Akti që i përket:

KËRKUES: AGRON AGALLIU, kandidat për deputet i subjektit politik “Bashkimi për Fitore”, përfaqësuar me prokurë nga Ilir Rusmajli.

SUBJEKTE TE INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.

2. YLLI BUFI, kandidat për deputet i Partisë Socialiste, përfaqësuar nga avokatët Ilir Panda e Mirash Martini, me prokurë.

3. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.67, përfaqësuar nga zonja Vjollca Bita.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.946, datë 28.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

BAZA LIGJORE: Nenet 113 e 141 të Kodit Zgjedhor

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të mësipërm:

- Komisionerët e Partisë Socialiste, Partisë Socialdemokrate dhe Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, kanë shpallur rezultatin duke u mbështetur në procesverbale të falsifikuara në disa prej qendrave të votimit.

- Në qendrën e votimit nr.12, është marrë për bazë një procesverbal i falsifikuar i ndryshëm në rezultat nga procesverbali që ne disponojmë. I njëjti fenomen ka ndodhur edhe në qendrat e votimit nr.25 dhe nr.26.

- Në qendrën e votimit nr.3, komisionerët e koalicionit “Bashkimi për Fitore” janë detyruar të largohen nga qendra e votimit nën kërcënimin e militantëve e komisionerëve socialistë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin nr.946, datë 28.6.2001 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore nr.67, duke njohur si fitues kandidatin për deputet të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, zotin Ylli Bufi. Kërkuesi Agron Agalliu, në bazë të nenit 141/1 të Kodit Zgjedhor, ka kërkuar në Gjykatën Kushtetuese shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Gjatë gjykimit rezultoi se kërkuesi nuk ka paraqitur ankim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kundër vendimit nr.1, datë 26.6.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhor nr.67. Në bazë të nenit 140/2 të Kodit Zgjedhor vendimet e Komisionit të Zonës Zgjedhor, me përjashtim të atyre që parashikohen në pikën 1 të këtij neni, mund të ankimohen brenda 2 (dy) ditëve nga shpallja e tyre në

Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, i cili vendos mbi ankimin brenda 2 (dy) ditëve nga shpallja e tyre në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa sipas nenit 141/1, vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve si dhe pavlefshmërinë e tyre, ankimohen në Gjykatën Kushtetuese brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tyre.

Pra siç shihet, Kodi Zgjedhor si procedurë fillestare për zgjidhjen e konflikteve zgjedhore ka parashikuar procedurën administrative dhe vetëm pas kësaj mund të konsumohet procedura gjyqësore. Në rastin në shqyrtim, përderisa kërkuesi nuk e ka konsumuar rrugën administrative për të kundërshtuar vendimin e Komisionit të Zonës Zgjedhore, ai nuk legjitimohet për të kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e kërkuesit Agron Agalliu duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës; nenit 141/1 të Kodit Zgjedhor si dhe neneve 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa nuk duhej rrëzuar pa një hetim të plotë të pretendimeve të kërkuesit e që kishin të bënin me goditjen për falsitet të të dhënave që përmbante tabela e rezultateve Model 39/1 hartuar nga Komisioni i Zonës Zgjedhore për qendrat e votimit nr.12 e 25.

Në radhë të parë, shumica duhej të kishte parasysh se procesverbali Model 54 që mbahet nga komisionet e qendrave të votimit, është dokumenti bazë që pasqyron rezultatin e verifikimit direkt të fletëve të votimit dhe të numërimit të votave sipas nenit 196 të Kodit Zgjedhor, kurse tabela Model 39/1 është përmbledhëse që Komisioni i Zonës Zgjedhore harton mbi bazën e procesverbaleve të mësipërme.

Në rastin në shqyrtim, kërkuesi paraqitti dy procesverbale Model 54 që i përkisnin qendrave të votimit nr.12 e 25, të cilat kishin të dhëna të ndryshme nga tabela Model 39/1 vetëm përsa i përket votave por zotit Ylli Bufi. Kështu, diferenca për qendrën e votimit nr.12 ishte për 72 vota, për qendrën e votimit nr.25 ishte për 230 vota.

Veç kësaj, kërkuesi pretendoi se tabela e Komisionit të Zonës Zgjedhore Model 39/1 është nënshkruar vetëm nga katër anëtarë dhe se veç shifrave të mësipërme kjo tabelë nuk pasqyron realitetin dhe përsa i përket numurit të përgjithshëm të qendrave të votimit. Kështu, nga 30 qendra votimi që pati zona nr.67, komisioni i zonës në tabelë pasqyron sikur janë 29 qendra votimi.

Në kushtet kur të dhënat e tabelës nr.39/1 goditen për falsitet, duke paraqitur dokumenta të cilat përbëjnë provë shkresore (procesverbalet Model 54 të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e komisionit e të vulosura rregullisht); kur diferenca e votave të përmendura më lart ka qenë vendimtare në shpalljen fitues të zotit Ylli Bufi (i cili vetëm për 149 vota ka kaluar kufirin e balotazhit) ishte detyrë imperative e Gjykatës t'i shkonte të vërtetës deri në fund.

Përkundrazi, shumica, pa asnjë argument bindës nuk shtrin verifikimin gjyqësor në dokumentet autentike e origjinale që normalisht duhet të përmbanin të dy kutitë e votimit të depozituara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Një hetim i tillë i pamjaftueshëm, duke i dhënë apriori prevalencë një dokumenti të prejardhur e me përmbajtje të dyshimtë ndaj dokumentit origjinal, e bën vendimin e shumicës të pambështetur në prova e në ligj.

ANËTAR
A.Karamuço